



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Njoftim publik

Nr. 05-391/02-88047/24 dt.08.07.2024, Nr. 05-391/02-88028/24 dt.08.07.2024, Nr. 05-391/02-88036/24 dt.08.07.2024

Drejtoria e Urbanizmit – Komuna e Prishtinës, ka filluar procedurën me numër nr05-391/02-88047/24 dt.08.07.2024, nr. 05-391/02-88028/24 dt.08.07.2024, nr. 05-391/02-88036/24 dt.08.07.2024 përmes së cilës kërkohet caktimi i adresave nga aplikuesi “ADA CONSULTING GROUP” shpk., dhe ka bërë propozimin për emërtim të këtyre rrugëve në ZK.Çagllavicë.

Agjencia Kadastrale e Kosovës e ka digjitalizuar (si rrugë të reja) segmentet e rrugës që shtrihet në këtë hapësirë, ndërsa Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës duke u bazuar në kërkesën e lartcekur si dhe Neni 2, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, Vendimin 01 nr. 031 -223419, dt. 02.10.2015 të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe Neni 5, Neni 6, pika 1.1.16., Neni 7, pika 1, pika 2, pika 3., 3.1., dhe pika 3.3., të Udhëzimit Administrativ Nr. 17/2019 të MMPHI – së, i ka dhënë këtyre dy rrugëve kodet të veçanta (kodi 19_15015, kodi 19_15016, kodi 19_15017, kodi 19_15018, kodi 19_15019, kodi 19_15020, kodi 19_15021, kodi 19_15022, kodi 19_15023, kodi 19_15024, kodi 19_15025, kodi 19_15026, kodi 19_15027, kodi 19_15028, kodi 19_15029, kodi 19_15030 dhe 19_15031) dhe ka bërë propozimin për emërtim e këtyre dy rrugëve.
Emrat e propozuara janë:

1. “Andrea Durrsaku”(1393-1389) ka qenë profesor i Universitetit Mesjetar të Durrësit .
2. “Barileva është një vendbanim në komunën e Prishtinës, Kosovë.
3. “Busia është një vendbanim në komunën e Prishtinës, Kosovë.
4. “Çlirimi” kalimi nga nje gjendje kufizuese ne nje gjendje te lire.
5. “Dr. Lec Gradica” (1954- 1998)Doktor.
6. “Dr.Shpëtim Robaj” (1957- 1998) Doktor.
7. “Gjakush Çapari” (1891- 1948) ishte një shkrimtar.
8. “Gjuzeffina Kosturi” (1912- 1985)Artistet
9. “Grashtica” është një vendbanim në komunën e Prishtinës, Kosovë.
10. “Hamdi Dragusha” (1906- 1989) Dëshmor.
11. “Hasan Ramadani” (1948- 1994) pjesëtar i lëvizjeve çlirimtare.
12. “Januz Zejnullahu” (1975- 1999) Dëshmor.
13. “Jeton Debushaj” (1975- 1999) Dëshmor.
14. “Kopliku Kopliku është qyteti më verior i Shqipërisë .
15. “Kraja” është tingull nordik në formë të koncentruar.
16. “Kruma e Hasit Kruma është një vendbanim dhe qender e komunës Krumë në rrethin e Hasit të Shqipërisë..
17. “Lugari” është një qytet në Qarkun Kakamega në ish Provincën Perëndimore të Kenias.
18. “Lumi i Marecit” Lumi është rrjedhë ujore natyrore e madhe, e përhershme ose periodike, që krijohet prej një apo më shumë burimeve, prej një akullnaje, liqeni prej shiut a shkrires së borës ne zk.Marec.
19. “Mamursai” është një qytet që ndodhet në Rrethin e Kurbinit në Shqipëri.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 04.10.2024 deri më 11.10.2024, në E-mail adresën: urbanizmi@prishtine.gov.net Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 17/2019 të MMPHI –së, për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtim, listës rezervë dhe vendosjen e tyre nga regjistri komunal, neni 7, paragrafët 1, 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në web-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në web-faqe të Komunës. Në të gjitha komentet tuaja duhet të përkthohet numri i kërkesës të shënuar më lartë si dhe kodi i rrugës përkatëse.



Nënshkrimi i Zyrtarës:



Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Urbanizmit

Adresa: rr. “Radovan Zogoviç” nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242
e-mail: urbanizmi@prishtine.gov.net